



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III
Komisioni për Integritime Evropiane
Mbledhja nr. 38
Prishtinë, më 02. 07. 2009, në orën 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
i mbledhjes së Komisionit për Integritime Evropiane

Morën pjesë: Zylfije Hundozi, Bujar Bukoshi, Džezair Murati, Hydajet Hyseni, Sabri Hamiti, Fatmir Rexhepi, Njomza Emini dhe Naser Rugova.

Munguan: Edita Tahiri, Nait Hasani dhe Branislav Grbiq.

Nga stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha dhe Adelina Demolli.

Mbledhjen e kryesoi: Zylfije Hundozi - kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 25. 05. 2009, 03. 06. 2009 dhe 08. 06. 2009;**
- 3. Takim me Dr. Christoph Zoepel, ish- deputet në Bundestagun Gjerman;**
- 4. Shqyrtimi përfundimtar i Raportit të hartuar për Planin e Veprimit për sfidat e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit për auditivin e brendshëm me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 6. Shqyrtimi i Draft – Letrës së Bardhë;**
- 7. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës.**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 25. 05. 2009, 03.06 2009 dhe 08. 06. 2009;
Procesverbalet e mbledhjeve të 25. 05. 2009, 03. 06. 2009 dhe 08. 06. 2009 u miratuan pa vërejtje.

3. Takim me Dr. Christoph Zoepel, ish-deputet në Bundestagun Gjerman;

Kryesuesja e njoftoi Christoph Zoepel-in me anëtarët e Komisionit dhe për fushëveprimtarinë e Komisionit për Integritet Evropian.

Christoph Zoepel pyeti cilat janë pritjet reale ndaj institucioneve të Bashkësisë Evropiane për vitin e ardhshëm. Deshi të dinte a kanë pasur mundësi të diskutojnë për Raportin e Progresit dhe nëse po a ka pasur kritika?

Kryesuesja – Theksoi se në muajin nëntor presim publikimin e Raportit të Integritetit Evropian për Kosovën dhe shpresojmë se do të jetë një raport pozitiv. Më vonë do ta nënshkruajmë Marrëveshjen e stabilizim- asociimit dhe do të punojmë që të na njohin edhe pesë shtete, që ende nuk na kanë njohur. Po ashtu tha se do të punojmë të jemi në pozitën e vëzhguesit në Këshillin Evropian dhe të anëtarësohemi si anëtar me të drejta të plota. Sa i përket Raportit të Progresit tha se pas publikimit të Raportit nga ana e Komisionit Evropian kemi ftuar përfaqësuesin e Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian dhe zëvendëskryeministrin e caktuar për Integritet Evropian. Pas këtyre takimeve kemi hartuar Planin e Veprimit për sfidat e dala nga Raporti i Progresit.

Naser Rugova - Sa i përket Raportit të Progresit për Kosovën tha se kemi pasur kritika, adresime dhe vërejtje serioze për fushat e caktuara. Në këtë raport ka edhe adresime, nganjëherë konfuzë dhe vërejtje që nuk përkojnë me realitetin e ri të Kosovës. Njoftoi se në seancën plenare, kur është diskutuar për këtë raport, janë dhënë vërejtje, kritika dhe sugjerime për institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës. Tani në prag të Raportit të ri të vizibilitetit, që do të jetë një raport shumë i rëndësishëm për qasjen se si Kosova më tutje do të ecë në procesin e integriteteve. Sfidë tjetër për Kosovën, tha, është Raporti i marrëdhënieve kontraktuale të BE-së veç e veç me shtetet e rajonit për procesin e liberalizimit të vizave. Përveç problemit që pesë shtetet e BE- së, që s’e kanë njohur Kosovën, Kosovës po i bëhet padrejtësi të ketë qasje të plotë në përmbushjen e kriterëve që i kërkon ky proces. Si shembull mori çështjen e riatdhesimit të shtetasve tanë nga Gjermania. Nëse Serbia nuk e nënshkruan Marrëveshjen e liberalizimit të vizave, Kosova do të dëmtohet seriozisht, sepse ndodh të mbetet vend i izoluar dhe do të rrezikohen zhvillimi i ekonomisë, qarkullimi i lirë i mallit dhe kapitali, sepse kosovarëve po u bëhet e pamundshme qasja në trendet e zhvillimit global në rajon, qoftë në Evropë. Andaj kërkoi mbështetje lidhur me këtë çështje, sepse tha: ‘Dimë t’i adresojmë çështjet ashtu siç kërkohet’.

Hydajet Hyseni - Lidhur me atë se çka presin nga institucionet e BE- së tha se është përparësi që qytetarët e Kosovës janë për integritet. Kosova ka vështirësi specifike. Në Raportin e Progresit adresohen një sërë çështjesh reale, por ka edhe vërejtje joreale. Pjesë e madhe e Raportit përmban vërejtje për trajtimin e minoriteteve, ndërsa në synojmë standardet më të avancuara evropiane për mbrojtjen e minoriteteve, por në emër të decentralizimit synohet copëzimi etnik i Kosovës. Në emër të mbrojtjes së monumenteve të Kosovës etnizohet çështja e monumenteve

në kundërshtim me parimet kushtetuese. Po na imponohen standarde të dyfishta, ndryshe në Kosovë, ndryshe në Maqedoni e ndryshe në Preshevë. Ndonjëherë kritikohemi edhe për raportet ndërmjet institucioneve, ku thuhet se agjendën e Kuvendit e cakton Qeveria. Unë këtë vërejtje e kam marrë si kompliment për Qeverinë, sepse çdo Qeveri e suksesshme e cakton agjendën për Kuvendin. Sa i përket vërejtjes se mungon vullneti politik për ta luftuar korrupsionin s'ë kuptoj se si mund të matet vullneti, por duhet të themi na mungojnë mekanizmat për ta luftuar korrupsionin. Ne duhet ta kujtojmë se në Raportin e Progresit kërkohet përgjegjësi edhe për fushat për të cilat ne nuk kemi përgjegjësi, siç është drejtësia.

Christoph Zoepel - Tha e kuptoj se çështja e minoritetit serb është çështje specifike dhe se ju jeni duke provuar t'i trajtoni minoritetet në formën evropiane, mirëpo në disa revista është shkruar edhe për minoritetet e tjera. Sa i përket caktimit të agjendës nga ana e Qeverisë për Kuvendin tha se Kuvendi ka dy pozicione shumë të rëndësishme, ai i pozitës - që duhet t' i zbatojë qëndrimet e Qeverisë dhe të opozitës dhe ta kontrollojë Qeverinë. Sa i përket luftimit të korrupsionit konsideroi se nuk ka vullnet as nga ana e Bashkësisë Evropiane t' i dënojë ata për të cilët ka fakte se janë të korruptuar. Kjo do të thotë se Kuvendi duhet të garantojë funksionim të gjyqësisë. Propozoi që BE- ja të përqendrohet në ndërtimin e sistemit gjyqësor. Shtoi se është e pakuptimtë që BE- ja vetëm të hartojë raporte e të mos ndihmojë.

4. Shqyrtimi përfundimtar i Raportit të hartuar për Planin e Veprimit për sfidat e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008;

Pas diskutimeve të deputetëve kryesuesja konstatoi se Komisioni nxori këtë

Përfundim

Raporti përfundimtar do të hartohet në mbledhjen e radhës më 06.07.2009.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për auditivin e brendshëm me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryesuesja, referuese e këtij projektligji- Ky ligj është në harmoni me direktivat evropiane për auditivin e brendshëm, andaj si i tillë mund të procedohet për miratim në Kuvend.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni nxori këtë

Përfundim

Projektligji për auditivin e brendshëm, me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk i cenon parimet themelore të Acquis Communautaire dhe politikat e BE-së.

6. Shqyrtimi i Draft –Letrës së Bardhë.

Kryesuesja ftoi deputetin Naser Rugova ta paraqesë Raportin e takimeve që janë mbajtur për Draft- Letrën e Bardhë.

Naser Rugova- Njoftoi se përpilimi i Letrës së Bardhë është bërë me një proces dinamik që ka pasur për qëllim përvetësimin, përafrimin dhe pasqyrimin në formë sa më koherente dhe më të qëndrueshme të këndvështrimit dhe të informacioneve të artikuluar të deputetëve. Shtoi se Letra e Bardhë ka pësuar ndryshime në vazhdimësi pasi janë përfshirë vërejtjet, sugjerimet, rekomandimet dhe kërkesat e deputetëve. Kërkoj nga Komisioni ta dërgojë rekomandimin që Letra e Bardhë të procedohet në Kryesinë e Kuvendit.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni nxori këtë

Përfundim

T'i rekomandohet Kryesisë procedimi i Draft- Letrës së Bardhë për miratim në seancë plenare.

Mbledhja përfundoi në orën 15:30.

E hartoi:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryesuesja e Komisionit

Zylfije Hundozi